

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjiçanit merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej 499 € (katërqindëntëdhjetenëntë euro) për Gëzim Brestovci për organizimin e ekspozitës personale "Gjuhë të ndryshme, Mendësi e njëjtë".
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione-Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Mjetet derdhen në emër të Gëzim Brestovci në llogarinë nr. 2017000012354921 TEB Banka.
4. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionim e përfituesit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.


Vendimi i dorëzohet:

- Palës,
- DBF, DKRS dhe
- Arkivit.

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni





**KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDİYESİ**

MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

ndërmjet

Komunës së Gjilanit, si autoritet publik

dhe

Gëzim Brestovci nga Gjilani, përfitues

Gjilan, 2022

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja financiare e Gëzim Brestocit nga Gjilani, për organizimin e ekspozitës personale "Gjuhë të ndryshme, Mendësi e njëjtë", sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren 01. nr. 016-126422 dt. 29.12.2016 e ndryshuar dhe plotësuar me rregulloren nr. 2/208,01 nr. 016-28468 dt. 22.03.2018 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve (neni 22 paragrafi 1.8)

Neni 2

Vlera e Subvencionimit

1. Vlera e subvencionimit është shuma prej 499 € (katërqindëntëdhjetenëntë euro) dhe ndahet nga Kodi Buxhetor- Subvencione -Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Kjo është shuma e vetme dhe përfundimtare që paguhet nga Komuna e Gjilanit për përfituesin.

Neni 3

Obligimet e palëve

1. Obligimet e përfituesit të subvencionit janë :
 - 1.1. mjetet e marra, përfituesi do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet e paraqitura në projekt.
 - 1.2. përfituesi duhet të raportoj tek Komuna e Gjilanit brenda 30 ditëve, pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.
2. Përfituesi duhet të sjellë tek Komuna e Gjilanit:
 - 2.1. raportin narrativ (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje) raportin financiar për mjetet e shpenzuara (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje)
 - 2.2. njofton Komunën e Gjilanit për çdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit

Neni 4

1. Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:
 - 1.1. obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje, t'ia transferoj në xhirollogarinë bankare të përfituesit, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;
 - 1.2. bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.
2. Komuna e Gjilanit mban të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

Neni 5
Afatet kohore

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.
2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

Neni 6
Shkëputja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rast të:
 - 1.1.tejkalimit të pa justifikuar të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje;
 - 1.2.marrëveshjes me shkrim nga të dyja palët në marrëveshje;
 - 1.3.shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë paraqitur me këtë marrëveshje dhe
 - 1.4.mos realizimit të subvencioneve për shkaqe objektive.

Neni 7
Kthimi i mjeteve

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve apo zvogëlojnë punën sipas vëllimit të paraparë me projekt, përfituesi është i obliguar t'i kthejë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

Neni 10
Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta për secilën palë.

Komuna e Gjilanit
Alban Hyse, Kryetar



Gëzim Brestovci

